



PLOTËSIM NDRYSHIMET E STATUTIT TË KOALICIONIT TË OJQ-VE PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE

Në Nenin 2 të statutit bazik i emëruar "Emri, forma dhe adresa", paragrafi 2.6, zëvendësohet me paragrafin si vijon:

2.6 Koalicioni e ka zyrën e saj qendrore në: Rrugën Zenel Salihu, OB.1 HY.1 K.3 Nr.16, 10000 Prishtinë, Kosovë.

Neni 4. i statutit bazik, "Misioni" ndryshohet dhe riformulohet si vijon:

Neni 4 Misioni

Promovimi dhe avancimi i të drejtave të fëmijës, përmes; avokimit, lobimit dhe monitorimit konform legjislacionit dhe instrumenteve ndërkombëtare.

Në Nenin 9 të statutit bazik me titull "Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme", paragrafi 9.3 i statutit bazik, ndryshohet dhe zëvendësohet me paragrafin si vijon:

9.3 Për mbajtjen e mbledhjes është e nevojshme pjesëmarrja e së paku 50% +1 e anëtarëve me drejtë vote. Në rast të mos-arritjes së kuorumit në Asamblenë e Përgjithshme, atëherë Bordi Drejtues cakton datën e re të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

Në Nenin 10 të statutit bazik me titull "Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme", shtohet paragrafi i ri 10.14 si vijon:

10.14 Asambleja e Përgjithshme nxjerr Rregullore për anëtarët, Kod të Mirësjelljes dhe të tjerë, të cilat sigurojnë dhe garantojnë funksionimin e koalicionit. Aktet e tilla aprovohen me votat e 50% +1 të anëtarëve me të drejtë vote prezent në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 11 i statutit bazik me titull "Bordi Ekzekutiv", ndryshohet dhe zëvendësohet me Nenin 11 si vijon:

11.1 Bordi Drejtues përfaqëson interesat e KOMF gjithmonë duke vepruar në pajtim me këtë statut, rregulloret dhe politikat e koalicionit.

11.2 Bordi Drejtues zgjedhet nga Asambleja e Përgjithshme e koalicionit dhe përbëhet nga 5 anëtarë: Presidenti i Bordit Drejtues, Zëvendës Presidenti i Bordit Drejtues, dhe 3 anëtarë. Bordi nuk mund të ketë më shumë se një anëtarë nga një organizatë. Çdo anëtar i Bordit Drejtues zgjedhet me një afat prej 2 viteve me numrin më të madh të votave nga Asambleja e Përgjithshme. Anëtarit ka mundësi të rizgjidhet jo më shumë se 2 herë radhazi.

11.3 Procedurat e zgjedhjes së anëtarëve përcaktohen në Rregulloren e Bordit e miratuar nga Asambleja e Koalicionit .

11.4 Anëtarët e Bordit Drejtues duhet të jenë anëtarë të organizatave anëtare të koalicionit, të jenë të pavarur dhe të paanshëm politikisht, të dëshmuar për promovimin e të drejtave të njeriut / fëmijës dhe të kenë të paktën përvojë 5 vjeçare në këtë fushë.

11.5 Zgjedhja e çdo anëtarit të Bordit Drejtues, bëhet i plotfuqishëm në momentin e aprovimit dhe nënshkrimit të procesverbalit nga ana e anëtarëve të Asamblesë së përgjithshme të Koalicionit.

11.6 Mandati i anëtarëve të Bordit - mund të pushoj: në rast vdekje, dorëheqje ose shkarkim nga detyra.

- 11.7 Anëtarët e Bordit Drejtues mund të shkarkohen para përfundimit të mandatit me votat e MPV-së dhe MPJ-së të Asamblesë së Përgjithshme.
- 11.8 Në rast të vdekjes, dorëheqjes ose shkarkimit të anëtarit të Bordit Drejtues, Asambleja e Përgjithshme duhet të zgjedh në mënyrë automatike anëtarin më të votuar nga zgjedhjet e fundit si anëtar të ri të Bordit Drejtues.
- 11.9 Në rast të barazimit në vota të dy anëtarëve të fundit më të votuar, dy më të votuarit do të shkojnë në ri votim. Anëtari i ri i Bordit Drejtues do të zgjedhet me shumicë të thjeshtë të Asamblesë së Përgjithshme.
- 11.10 Anëtarët e Bordit Drejtues ushtrojnë detyrën e tyre duke u udhëhequr nga mbrojtja e interesave të gjithë anëtarëve të koalicionit.
- 11.11 Anëtarët e Bordit Drejtues janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar ndaj reputacionit të Koalicionit.
- 11.12 Secili anëtar i Bordit Drejtues mund të abstenojë prej votimit për marrjen e vendimeve ose për çfarëdo çështje tjetër për të cilën ai ose ajo ka interes personal ose ekonomik.

Neni 12 i statutit bazik me titull "Përgjegjësitë e Bordit Ekzekutiv", riformulohet dhe zëvendësohet më tekstin si vijon:

- 12.1 Mbikëqyr realizimin e veprimtarisë dhe implementimin e programeve / projekteve të koalicionit.
- 12.2 Aprovon programin vjetor të aktiviteteve të koalicionit dhe raportin buxhetor, i cili pastaj votohet në Asamblesë të Përgjithshme.
- 12.3 Mbikëqyr administrimin e fondeve të menaxhuara nga sekretariati.
- 12.4 Bordi Drejtues takohet së paku 4 herë në vit. Në raste të caktuara, Bordi mund të mbledhet sipas nevojës.
- 12.5 Aprovon draftin e programit vjetor të aktiviteteve të koalicionit dhe raportin buxhetor, i cili paraqitet në Asamblesë të Përgjithshme për aprovim.
- 12.6 Mund të vendos marrëdhënie bashkëpunimi me organizata të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.
- 12.7 Aprovon idetë për projekte dhe programe për përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave të koalicionit.
- 12.8 Vendimet e Bordit Drejtues janë të vlefshme kur ato merren nga shumica e të gjithë anëtarëve të Bordit Drejtues.
- 12.9 Bordi Drejtues mund t'i drejtohet për çfarëdo çështje Asamblesë së Përgjithshme për marrje të vendimit.
- 12.10 Bordi Drejtues mund të kërkojë nga asambleja e përgjithshme të krijojë bord këshillues.
- 12.11 Bordi Drejtues harton akte të nevojshme sikurse rregullore të brendshme për Bordin Drejtues, për të siguruar mirëfunksionimin e Bordit. Aktet e nxjerra nga Bordi Drejtues, aprovohen me shumicë të anëtarëve me drejtë vote të Asamblesë së Përgjithshme.
- 12.12 Drejtori Ekzekutiv zgjidhet nga Bordi, në pajtim me Rregulloren për punën e Bordit.

Neni 14 i Statutit bazik – Zyrtarët dhe Nëpunësit, zëvendësohet me tekstin si më poshtë:

Neni Sekretariati i KOMF

- 1.1. Bordi Drejtues dhe Drejtori Ekzekutiv do të zgjedhin Zyrtarë ose të pranojnë persona që të marrin përsipër kryerjen e detyrave të koalicionit në kuadër të sekretariatit.
- 1.2. Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve dhe nëpunësve përcaktohen në bazë të përshkrimit të punës.

Në Kreun III, Anëtarësimi, Nenin 15 të statutit bazik i emëruar "Anëtarësimi", shtohet paragrafi i ri 15.3 si vijon:

Neni 15 i statutit bazik – Anëtarësimi, riformulohet dhe zëvendësohet më tekstin si vijon:

15.1 Anëtarët e rinj duhet të përmbushin kushtet e më poshtme për tu anëtarësuar:

- Të kenë më shumë se 2 vjet eksperiencë si organizata.
- Të ndajnë të njëjtin mision dhe vizion me koalicionin.
- Të zotohen për të marrë pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet e Koalicionit.
- Të sigurojnë një referencë nga një partner dhe një donator;
- Të ketë politikën e brendshme të organizatës për mbrojtjen e fëmijëve.
- Duhet të sillen dëshmi që organizata dhe përfaqësuesi ligjor nuk kanë të kaluar kriminale.

15.2 Përrjashtim nga Neni 15.1, bëjnë organizatat anëtare të KOMF, të cilat nga organizata ndërkombëtare regjistrohen si organizata vendore, në rastet kur stafi, misioni e aktivitetet mbesin të njëjta. Procedura për rastet e tilla specifike është si vijon:

- Parashtrimi i dokumenteve sqaruese për ndryshimin e organizatës: dokumentin për shuarjen e organizatës ndërkombëtare si dhe dokumentet për regjistrimin si organizatë vendore;
- Verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të tillë nga Sekretariati i KOMF.

Nenin 17 në statutin bazik – Përfundimi dhe Mbrojtja e Anëtarësimi, riformulohet si vijon:

Neni 17– Përfundimi dhe Mbrojtja e Anëtarësisë

17.1 Vendimi për t'i dhënë fund një anëtarësimi pa pëlqimin e anëtarit, mund të bëhet në rastet e mëposhtme:

- Organizata nuk i ka përmbushur detyrimet e veta ndaj koalicionit, të përcaktuara me Nenin 18, paragrafi 8.
- Organizata nuk merr pjesë në asnjë aktivitet të KOMF për një periudhë 1 vjeçare, e cila dëshmohet nëpërmjet listave të pjesëmarrësve të aktiviteteve të KOMF njoftohet për fillimin e procedurës për përjashtim.
- Organizata nuk ka marrë pjesë në takimin e asamblesë për dy herë radhazi.
- Organizata ka shuar veprimtarinë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.
- Veprimtaria e organizatës bie në kundërshtim me misionin e KOMF.
- Anëtari nuk i përmbush më kriteret e anëtarësimi.

17.2 Procedura për përjashtimin e anëtarëve pasiv të KOMF nisat nga Drejtori Ekzekutiv i KOMF, konfirmohet nga Bordi dhe aprovohet nga Asambleja.

17.3 Në momentin e nisjes së procedurës së përfundimit të anëtarësimi, jo më pak se 7 ditë para mbajtjes së takimit të Asamblesë, Drejtori i KOMF obligohet që ndaj organizatës anëtare që ka filluar procedura e përjashtimit ta njoftoj për këtë procedurë në e-mail zyrtar të organizatës dhe përfaqësuesit të autorizuar. Njoftimi përmban arsyen e nisjes së procedurës së përjashtimit së bashku me te drejtat e organizatës anëtare të dëshmojnë aktivitetin e saj.

17.4 Procedura e përjashtimit të një organizate mund të ndërpritet vetëm në rast se organizata anëtare ofron dëshmi të mjaftueshme për aktivitetin e saj në kuadër të KOMF. Për një veprim të tillë, Drejtori Ekzekutiv i KOMF njofton Bordin për ndërprerjen e procedurës së përjashtimit të organizatës anëtare.

17.6 Anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme do të sjellin vendimin për dhënien fund të një anëtarësimi pa pëlqimin e anëtarëve. Kjo siguron paanësinë në procesin e vendimmarrjes dhe kështu krijohen kushtet e nevojshme për mbrojtjen e anëtarit.

17.5 Organizatat anëtare ndaj të cilave është iniciuar masa e përjashtimit, nuk merren parasysh për kuorum për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të KOMF.

Në Kreun IV: Rregullimi Ekonomik i Koalicionit të statutit bazik, shtohet një nen i ri, Neni 20 me titull "Pagesa për anëtarësi" si vijon:

Neni 20 – Pagesa për Anëtarësi

- 20.1 Anëtarët e koalicionit do të paguajnë një shumë vjetore për anëtarësi.
- 20.2 Shuma e pagesës vjetore për anëtarësi përcaktohet me vendimin e shumicës së anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme.
- 20.3 Pagesa e anëtarësisë bëhet në baza vjetore në fillim të çdo viti kalendarik, por jo më vonë se në datën 15 prill të vitit për të cilin bëhet pagesa e anëtarësisë.
- 20.4 Jo më vonë se më 1 prill të vitit për të cilin bëhet pagesa e anëtarësisë, Sekretariati i KOMF obligohet që organizatat anëtare të cilat nuk e kanë bërë pagesën e anëtarësisë t'i njoftojë për obligimin e tyre, në e-mailin zyrtar të organizatës dhe përfaqësuesit të autorizuar.
- 20.4 Të gjitha shpenzimet e bëra nga ky fond duhet të bëhen me aprovimin paraprak nga Bordi Drejtues i koalicionit.
- 20.5 Përveç raportit financiar vjetor të koalicionit cili i dërgohet të gjithë anëtarëve të asamblesë së përgjithshme më së largu deri në fund të marsit të vitit të ardhshëm për vitin paraprak, paratë e mbledhura nga pagesa e anëtarësisë do të raportohen si vijë e veçantë për shpenzimet e parave nga ky fond.

Neni me titullin "Bordi Këshillues" shtohet si nen i ri

- 1.1 Me propozimin e sekretariatit, anëtarët e Bordit Këshillues miratohen nga shumica e anëtarëve të Asamblesë.
- 1.2 Bordi Këshillues do të përbëhet nga persona që janë të interesuar për misionin dhe parimet e KOMF.
- Bordi Këshillues angazhohet për avancimin e objektivave strategjike zhvillimore të KOMF.
- 1.3 Bordi Këshillues do të këshillojë Bordin Drejtues dhe Sekretariatit për çdo çështje që vihet para tij.
- 1.4 Bordi Këshillues nuk do të ketë ose nuk do të pretendojë të ushtrojë asnjë kompetencë të Bordit Drejtues apo të Sekretariatit.